

Duke Mbrojtur Privatësinë online të Fëmijëve Mbrojmë të Ardhmen e tyre



I DASHUR PRIND!

Bashkëpunoni me fëmijën tuaj, këshilloje atë. Për këtë kujdes sot fëmija do të të falenderojë nesër.

Çfarë mund të bëni ju prindër për të mbrojtur të dhënat personale të fëmijëve tuaj kur ato janë duke vizituar faqet e internetit?

- Kontrolloni faqet e internetit që përdorin fëmijët tuaj!
- Vëzhgoni politikat e privatësisë që përmbajnë faqet e internetit, rrjetet sociale dhe faqet e personalizuar.
- Bëni zgjedhje në lejen tuaj!

Në shumë raste, faqet e internetit kërkojnë aprovimin tuaj para se t'i

lejohej për të mbledhur informacion personal. Ata mund të kërkojnë lejen tuaj në disa mënyra, duke përfshirë adresën, numër tel, etj.

- **Bëni pyetje dhe kërkoni më shumë!**
Nëse ju nuk jeni të qartë mbi praktikën apo politikën e një vendi, pyetni rreth tyre.
- **Në ndihmën tuaj vjen gjithashtu!**

www.ceop.gov.uk

Si prind vlerëso dhe kontakto këtë adresë. Vazhdimisht kjo të ndihmon të ruash e sigurosh fëmijën tuaj gjatë përdorimit të internetit, të shton interesimin për të lexuar në sytë e fëmijës atë çfarë ai kërkon të dijë dhe atë çfarë ti duhet ti tregosh...

Më shumë Këshilla për Ju Prindërit

- **Diskutoni dhe bisedoni shpesh me fëmijët tuaj!**
- **Flisni me fëmijët tuaj, flisni me miqtë e tyre, bëjini të kuptojnë rreziqet e Internetit!**
- **Kontrolloni se në çfarë faqesh interneti hyjnë fëmijët tuaj!**

Bisedoni me fëmijët tuaj në lidhje me faqet e internetit që ata pëlqejnë të vizitojnë. Bëni disa kërkime tuajat vetë për të njohur se si faqja punon dhe çfarë rregulla të privatësisë dhe kontrollesh ato ofrojnë.
- **Bëni marrëveshje!**

Bisedoni ngrohtësisht me fëmijën. Sigurohuni që fëmijët tuaj ta dinë se çfarë është për

familjen tuaj në rregull dhe çfarë jo – për të mos e zbuluar në internet.

- **Insistoni për të mësuar se si fëmijët tuaj hyjnë në internet!**

Fëmijët mund të hyjnë në internet duke përdorur kompjuterin e familjes apo të dikujt tjetër si dhe nëpërmjet telefonave celularë, etj.



Vizitoni www.onguardonline.gov për më shumë këshilla për sigurinë e kompjuterin tuaj, mbrojtjen e informacionit personal si dhe për t'u

mbrojtur ndaj mashtrimit të internetit.



Për më shumë Ju mund të kontaktoni me:

Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

në Adresën:

Rr. e Kavajës, Nd 80, H.1, Tiranë

Tel:+35542237200, Fax: +35542233977

e-mail: info@idp.al,

web: www.idp.al